



Prot. Nr. 04/2026

LETËR SHPALLJEJE E VITIT JUBILAR MARIAN

**Kishës që është në Shqipëri,
meshtarëve, të kushtuarve dhe të kushtuarave,
besimtarëve laikë,
të gjithë burrave dhe grave vullnetmirë.**

Me rastin e 130-vjetorit të shpalljes së të Lumes Virgjër Mari, Nëna e Këshillit të Mirë, si Pajtorja e Shqipërisë, Konferenca Ipeshkvnore e Shqipërie, e mbushur me mirënjohje ndaj Zotit për dhuratat e dhëna Kishës sonë dhe popullit tonë, shpall solemnisht **një Vit Jubilar Marian**.

Me zemër falënderuese kujtojmë se, më 26 prill 1896, Kisha njohu zyrtarisht në fytyrën e ëmbël të Nënës së Këshillit të Mirë një shenjë mbrojtjeje dhe udhërrëfimi për Kombin tonë. Në Të, ndër shekuj, populli shqiptar ka gjetur ngushëllim në sprova, dritë në vështirësi, shpresë në kohë përndjekjeje dhe forcë në udhën e ringritjes.

Prandaj, vendosim që Viti Jubilar të fillojë **më 26 prill 2026** dhe të përfundojë **më 26 prill 2027**. Ftojmë të gjitha dioqezat, famullitë, bashkësitë rregulltare dhe lëvizjet kishtarë ta jetojnë këtë kohë si rast ripërtëritjeje shpirtërore, kthimi të zemrës dhe dëshmie ungjillore.

Ky Vit i Shenjtë qoftë për të gjithë kohë kthimi me besim tek Hyji, sipas shembullit të Marisë; kohë pajtimi dhe bashkimi kishtar; kohë rizbulimi të fesë dhe angazhimi të ripërtëritje misionar; kohë lutjeje të thellë për familjet, për të rinjtë, për thirrjet dhe për të ardhmen e Kombit tonë.

Ftojmë Barinjtë e dioqezave dhe të famullive të përgatisin kremtime solemne, shtegtime, momente katekeze dhe nisma bamirësie, që hiri jubilar të mbërrijë në zemrën e çdo besimtari. Bazilika e Nënës së Këshillit të Mirë në Shkodër do të jetë qendër shpirtërore dhe vend i privilegjuar shtegtimi gjatë gjithë Vitit Jubilar.

Ia besojmë këtë kohë hiri ndërmjetësimi të Virgjërës së Shenjtë, që të vazhdojë ta shoqërojë popullin shqiptar me këshillën e saj amënore, duke na udhëhequr drejt Krishtit, Shpëtimtarit të vetëm të botës.

Me këto ndjenja, japim me gjithë zemër bekimin tonë për të gjithë besimtarët.

Dhënë nga Selia e Konferencës Ipeshkvore të Shqipërisë,

Tiranë, më 11.02.2026, *Përkujtimi i së Lumes Mari Virgjër e Lurdit*

+ 
+ Giovanni Peragine

Arqipeshkëv Metropolit i Shkodër-Pultit

+ 
+ Arjan Dodaj


Arqipeshkëv Metropolit i Tiranë-Durrësit

+ 
+ Ottavio Vitale

Ipeshkëv i Lezhës

+ 
+ Gjergj Meta

Ipeshkëv i Rrëshenit

p. 
Atë Mariano Tarantino

Administrator Dioqezan i Sapës